

Prof. Rexhep Ismajli's linguistic studies on the early Albanian texts

Abstract: *Author Omari narrows her focus on the contribution of prof. Rexhep Ismajli to the field of early texts in Albanian. After accomplishing his studies in Prishtina and other well-known institutes in the West, prof. Ismajli devoted his time and efforts to the analysis of early Albanian texts. The results of such studies were the essays on "The graphs in Buzuku and some questions of the Albanian phonetical system." (GJA, 1972/2). In it, for the first time in Albanian linguistics, were applied the principles of structural phonology. Another important study was the critical edition of the manuscript from Grottaferrata (1710). Then, in 1985, prof. Ismajli published his doctoral study "The Albanian language in the Albanian Council", a phonological treatise on the 18th-century Albanian language. To this topic were applied the principles of functional linguistics along with those of the linguistics of the applied text.*

These form part of only the beginnings of his studies which were to score high in the years to come and encompass such fields as historical linguistics, phonetics, phonology, textual philology, history of written tradition and the linguistics of Albanian texts.

Akademiku Rexhep Ismajli vjen në ditëlindjen e tij të 70-të me një bilanc të admirueshëm punimesh shkencore dhe me një veprimtari shkencore të jashtëzakonshme. Nga CV e tij shihet se ai e filloi qysh herët veprimtarinë kërkimore e botuese në fushë të gjuhësisë, menjëherë mbas përfundimit të studimeve të larta për gjuhë e letërsi në Prishtinë e sidomos gjatë specializimit pasuniversitar në Institutin e gjuhësisë së përgjithshme e të zbatuar në Paris¹. Krahas studimeve për gjuhën e sotme, në fillim në fushë të fonologjisë, atë e tërhoqi qysh herët studimi i teksteve të vjetra shqipe, me mbështetje shkencore të kualifikuar të fituar edhe nga studimet e thelluara pasuniversitare në Gjuhësi indogjermane dhe të krahasuar në universitetin e Bochumit, Gjermani. Rezultati i parë i studimeve në fushën e

1 Ndër punimet e para të rëndësishme të kësaj periudhe hyn artikulli "A propos de la quantité vocalique de l'albanais", mbajtur si kumtesë në Kolokuiumin Albanologjik Ndërkombëtar kushtuar Norbert Joklit, në Innsbruck 1972, dhe botuar në aktet e këtij Kolokuiumi në vitin 1977 si dhe në shqip në *Gjurmime Albanologjike* III, 1973.

gjuhës së teksteve të vjetra shqipe është punimi “Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes”², ku për herë të parë në gjuhësinë shqiptare zbatohen parimet e fonologjisë strukturale në një studim për fonetikën e shqipes.

Në këtë punim, që ka për qëllim të zbulojë sistemin fonematik që qëndron prapa grafisë së tekstit të Buzukut, autori niset nga dy qasje metodologjike: nga studimi i gjendjes së sotme e gjuhës për ta projektuar në gjendjen gjuhësore të shqipes së shekullit XVI, siç ka qenë e zakonshme në studimet për Buzukun, por edhe nga interpretimi i grafisë së tekstit, e cila lejon të rindërtohen veçori fonetike reale të fazës përkatëse të shqipes, ndërkohë që sistemi i sotëm mund të ketë pësuar ndryshime në krahasim me kohën e Buzukut në një distancë kohore prej katër shekujsh. Kështu, së pari analizohet sistemi fonetik i gegërishtes së sotme, si një diasistem, i ndryshëm nga sistemi fonetik i gjuhës së përbashkët, i parë në projeksion diakronik. Për vetë qëllimin e punimit analiza përqendrohet në ato njësi të inventarit të fonemave për të cilat vetë Buzuku jep dëshmi materiale, dhe që në mjaft raste paraqiten problematike. Ndryshe nga studimet e deriatëhershme, në këtë punim fonemat analizohen sipas metodës bashkëkohore të gjuhësisë strukturale në marrëdhëniet e tyre në sistem dhe në vendin që ato kanë në këtë sistem. Edhe pse studimi i fonemave nuk është gjithëpërfshirës, ai ngre probleme që tregojnë për një studim të thelluar të sistemit fonetik të gegërishtes, si kërkesa për përcaktimin e statusit fonematik të zanoreve, përcaktimi i radhëve të opozicioneve, çështja e tipareve të kombinuara të fonemave në kuadër të nyjtimit në grupe fonemash, deri edhe analiza komponenciale e fonemave në raste të veçanta etj., që hapin shtigje për studime të mëtejshme të thelluara në këtë fushë. Për shembull, në sistemin e bashkëtingëllores një nga çështjet me interes është ajo e gjysmëbashkëtingëllores *u* (ose e fërkimore *v*) dhe raportit të saj me zanoren *u*, kundërvënia mes të cilave pohohet se është fonologjizuar vonë në shqipe duke rindërtuar dhe proceset fonologjike që kanë ndodhur në këtë mes, e që ruhet në ndonjë të folme shqipe të Malit të Zi në shqiptimin e emërvendit [pla:u] për Plavë. Çështja e bashkëtingëllores *h*, mjaft problematike në pasqyrimin e saj grafik te Buzuku, gjithashtu trajtohet në kundërvëniet e saj fonologjike duke u analizuar sipas tipareve të komponentëve, nga del se për shkak të zbrazëtisë sistimore që mbetet në tiparin fërkimor të saj, ajo pësoi transformime deri në zhdukje, si në të folmen e Dibrës, ku megjithatë ka gjurmë të saj në formën e një mbylljeje glotale, psh [’a.na] për *hana*.

Më pas merret në shqyrtim sistemi fonetik i gjuhës së Gjon Buzukut, në bazë të interpretimit të sistemit grafik të tekstit të tij. Në disa prej problematikave ai shkon më thellë se paraardhësit, duke u ndalur në

2 Botuar në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2, Prishtinë, 1972.

çështje grafike që shtrojnë probleme interpretimi e duke u përpjekur t'i shpjegojë në këndvështrimin fonologjik. Në gjatësinë e zanoreve që Buzuku e shënon jo konsekuentisht, autori shpreh bindjen e arsyetuar se kjo gjatësi përbën ndërlidhni (lidhje korelative) në zanoret e shqipes së asaj periudhe, ashtu si në disa të folme të sotme që ruajnë tipare të vjetra, ndërsa zanoret gjysmë të gjata janë variante fonetike herë të njëres njësi herë të tjerës. Ai arrin të shpjegojë fonetikisht edhe gjatësinë në fjalë të tipit *beekuom*, *peenduom*, si një realitet tingullor dhe jo shkrimor, si gjatësi në fjalë dytheksore ['be:'kuom, 'pe:'nduom] dhe jo në rrokje të patheksuar.

Autori sjell një interpretimin të ndryshëm për përdorimin shumë problematik dhe pamiratuar njëzëri të dy shkronjave *u* (latine) dhe *8* (cirilike) te Buzuku, ku, mbasi paraqet zgjidhjet e propozuara deri tani nga studiuesit buzukianë, që paravendojnë një shumësi shqiptimesh të veçanta apo që bien në atomizëm dhe në etimologizëm, ai e shtron problemin brenda sistemit të një faze të caktuar gjuhësore, i cili mendon se duhet të përputhet disi me sistemin ekzistues, pavarësisht nga origjina e një tingulli. Çështjen e dyvlershmërisë fonetike të shkronjës *u* ai e sheh në korrelacionet e theksimit, të gjatësisë e të shkallës së hapjes së zanores dhe në raportet mes tyre. Si përfundim i analizës së këtyre raporteve dhe në bazë të shembujve që ofron teksti i Buzukut, ai arrin në përfundimin se dallimi mes dy grafive të ndryshme te Buzuku nuk pasqyron dallimin [u] zanore dhe [u] gjysmëzanore ([ɯ]), por dallimin [u] e hapur dhe [u] e mbyllur, ku zanorja e hapur shënohet me shkronjën sllave. Kjo zgjidhje e tij përkon deri diku me mendimin e Selman Rizës në një studim të tij të hershëm kushtuar vlerës fonetike të grafive buzukiane në fjalë³, që autori vështirë se do ta ketë pasur në dorë. Në këtë studim të vitit 1958 Riza kundërshtonte mendimin e Joklit për vlerën diftongore të saj dhe argumentonte me një analizë filologjike të mbështetur edhe në statistika se shenja 8, përveç fonemës [y], përfaqëson tingullin e thjeshtë *u*, të shkurtër e të përdorur vetëm në raste të veçanta.⁴ Kjo zgjidhje e tij mbështetej në realitetin fonetik të së folmes së Gjakovës, në rastet e shqiptimit të zanores *y* si zanore e shkurtër e theksuar e hapur në fjalë si *fyt* etj.

Edhe çështje të tjera të vështira të grafisë së Buzukut si ajo e *h*-së iracionale apo e grafive *en*, *em* para disa bashkëtingëlloreve interpretohen dhe arsyetohen sipas teorisë fonologjike.

Me një bagazh të tillë formimi të plotë gjuhësor e filologjik dhe me përvojën e fituar në studimet e para rreth shqipes së teksteve të vjetra, ai mund të ndërmernte punime të rëndësishme në fushën e teksteve të vjetra dhe gjuhës së tyre, siç ishte *Gramatika e parë e shqipes*, mbi dorëshkrimin

3 S. Riza, "Mbi vlerën fonetike të grafivet buzukjane 8 (sllave) dhe u (latine)", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës - Seria Shkencat Shoqërore*, 1958, nr. 1, f. 81-84.

4 S. Riza, "Mbi vlerën fonetike të grafivet buzukjane 8 (sllave) dhe u (latine)", art. i cit.

e vitit 1710 të Grottaferratës, riprodhuar të plotë në botim kritik filologjik, me studimin e grafisë dhe të sistemit fonematik të gjuhës së veprës, botuar në vitin 1982 në Prishtinë. Të dhënat gjuhësore të dorëshkrimit të Grottaferratës janë përfshirë në mënyrë implicite dhe kanë shërbyer për krahasime në punimin vijues.

Ndërkohë Rexhep Ismajli kishte filluar tashmë punimin e tij të doktoratës *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706) – hulumtime grafiko-fonologjike*, të cilin e mbrojti me sukses në Prishtinë në vitin 1982 dhe e botoi në vitin 1985⁵.

Për gjuhën e autorëve të vjetër deri në atë kohë ishin bërë pak studime, ku spikaste puna e bërë nga Çabej për gjuhën e Gjon Buzukut, kryesisht në rrafshin e fonetikës e më pak të morfologjisë, si dhe studimet e Selman Rizës në rrafshin morfologjik. Studime të karakterit fonologjik thuhet nuk kishte, përveç analizës së thukët të Martin Camajit mbi sistemin fonologjik të gjuhës së tekstit të Pjetër Bogdanit në parathënien e ribotimit anastatik të Cuneus Prophetarum. Studimi *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit* është një traktat fonologjik i shqipes së fillimit të shekullit XVIII, i vështuar sipas metodës së gjuhësisë funksionale, me kontribute edhe për fonologjinë e shqipes bashkëkohore.

Teksti i Kuvendit të Arbënit që është zgjedhur për hulumtim është një tekst me rëndësi të veçantë për historinë e gjuhës e të kulturës shqiptare, si dhe për historinë kishtarë të Shqipërisë. Ai zë një vend të rëndësishëm mes shkrimeve të vjetra shqipe si një tekst i gjerë i një faze të shqipes që shkon deri në mesin e shekullit XVIII dhe përmbyllet me Doktrinën e Kërshten të Gjon Kazazit. Kjo fazë sipas periodizimit të gjuhës shqipe konsiderohet faza e hershme e shqipes së re, ndërsa sipas një periodizimi që bazohet në periudhat letrare të shqipes, quhet shqipja e vjetër dhe përfshin periudhën nga mesi i shekullit 16 deri në fund të shekullit 18⁶. Ky tekst mbush një zbrazëti të ndjeshme të dokumentimit gjuhësor të shqipes nga teksti i Bogdanit (1685) në atë të Kazazit (1743).

Punimi karakterizohet nga një qasje sintetizuese në pjesën hyrëse të rrethanave historike, sociale e fetare të mbajtjes së Kuvendit të Arbënit dhe vendimeve që dolën prej tij dhe nga një metodë sistemo-analitike në kapitujt e analizës grafike e fonematike të tekstit.

Pjesa e parë përmban konsiderata të rëndësishme rreth tekstit të Kuvendit të Arbënit e gjuhës letrare të tij, kontekstit të mbajtjes së Kuvendit, organizatorit dhe frymëzuesit të Kuvendit, botimeve në rrjedhën e kohës të akteve të Kuvendit, përmbajtjes dhe rëndësisë së vendimeve të tij, përsiatjeve mbi autorin anonim të tekstit, studimeve të tekstit deri

5 R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706)*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

6 S. Schumacher & J. Matzinger, *Die Verben des Altalbanischen*, Albanische Forschungen 33, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2013, f. 21.

në kohën e daljes së punimit, etj. Në krahasim me studimet e mëparshme monografike për këtë tematikë, ky punim karakterizohet nga një vështrim më përgjithësues e më përfshirës, mbështetur në mënyrë përzgjedhëse në ato dokumente burimore që janë vërtet me interes për kthjellimin e disa çështjeve kyçe të historikut të problemit. Në një numër relativisht të kufizuar faqesh, janë paraqitur me mprehtësi problemet kryesore që i përkasin kësaj tematike, çka tregon për njohuri të gjera e formim solid të përgjithshëm të autorit në një moshë ende mjaft të re.

Autori vë në dukje vlerat dhe rëndësinë e tekstit të Kuvendit të Arbënit dhe vendin që zë ai midis teksteve të vjetra shqipe, shkallën e zhvillimit të shqipes së shkruar që pasqyron ai tekst dhe meritat e tij për stabilizimin e mëtejshëm të shkrimit të shqipes dhe për zgjerimin e stileve funksionale të saj, në vijim të rrugës së çelur nga Bogdani me veprën e tij madhore të fundshekullit 17.

Gjuha letrare e tekstit të Kuvendit vlerësohet edhe nga aspekti i koineizimit të saj, në hullinë e traditës së deriatëhershme të shkrimit shqip dhe që arriti shkallën më të lartë me “koinenë” e gegërishtes veriore të Bogdanit, përkundrejt lëvizjes letrare të gjysmës së dytë të shekullit 19 të qarkut katolik verior me qendër në Shkodër, që shkon në drejtim lokalizues e partikularist të një gjuhe më popullore por më të kufizuar krahinore. Ky lokalizëm fetar e krahinor madje gjykohet se e veçoi traditën letrare shkodrane nga drejtimi mbarëkombëtar i Rilindjes dhe ia preu perspektivën e zhvillimit të mëtejshëm standardizues. Në këtë drejtim teksti i Kuvendit është më përpara se pasardhësit e tij një shekull më vonë⁷.

Teksti i Kuvendit të Arbënit çmohet edhe nga rëndësia që ka për historinë e gjuhës shqipe, për zhvillimin e leksikut të shqipes dhe historinë e huazimeve në të, për faktin se mund të shërbejë edhe si korpus i shkrimit të shqipes nga të huajt me qëllim që nëpërmjet analizës së gabimeve të një përdoruesi joburimor të shqipes, të evidentohen strukturat e përkthyer, joautentike të autorëve burimorë të shqipes, për historinë e kulturës shqiptare, ku dalin edhe funksionet sociale të gjuhës shqipe, për ndikimin që pati për mësimin e gjuhës shqipe në nxënësit e kolegjeve të Italisë dhe tek priftërinjtë e famullitarët në Shqipëri ku pati përhapje të gjerë në dioqezat katolike.

Autori ndalet në figurën dhe personalitetin e Vinçenc Zmajeviqit, intelektual i shquar i kulturës kroate dhe dashamirës shqiptarëve, i cili kur ishte arqipeshkëv i Tivarit organizoi kuvendin e Arbënit në Mërquinjë të Lezhës në vitin 1703. Për ndriçimin më të plotë të figurës dhe të motivimit të veprimtarisë së tij autori ka meritën se vështron më gjerë kontekstin historik, politik e fetar dhe marrëdhëniet ndërpersonale me autoritetet e kohës. Në veprimtarinë e Zmajeviqit në dobi të kishës shqiptare vihet

7 R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit*, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 17.

në dukje angazhimi i tij për shqiptarizimin e klerit katolik. Përkundrejt përfitimit të paktë të kishës nga priftërinjtë e huaj që kryenin detyra në Shqipëri dhe duke qenë, me siguri, në dijeni të ankesave e përplasjeve të herëpashershme të klerikëve shqiptarë me ata të huaj, ai i kërkon Vatikanit shkollimin e klerit shqiptar. Një nga arsyet e ankesave të tij ndaj klerikëve të huaj ishte mosnjohja e gjuhës shqipe prej tyre.

Duke kaluar nëpër botimet e tekstit të Kuvendit në vite, studimi merr në vështrim përkthimin e ri të tij nga Engjëll Radoja në vitin 1872. Autori vlerëson personalitetin dhe kulturën e përkthyesit, arsyet dhe rëndësinë e marrjes përsipër prej tij të përkthimit si njohës i mirë i latinishtes dhe i shqipes së folur popullore, zgjedhjet gjuhësore që bëri me këtë rast, përsosjen e alfabetit të shqipes së vjetër dhe të drejtshkrimit të saj. Zgjedhja e të folmes popullore të Shkodrës si gjuhë e përkthimit, me qëllim që teksti të bëhej i kuptueshëm për shtresat e gjera të besimtarëve, vlerësohet nga ana e besnikërisë së sjelljes së tekstit në gjuhën popullore, të njohjes së dialektit të Shkodrës dhe shkallës së depërtimit të turqizmave në të në kohën e tij.

Në pjesët që i kushtohen tekstit të Kuvendit në vetvete dhe përbëjnë trungun kryesor të punimit, para se të ndalet me hollësi në çështjet e grafisë së tekstit të Kuvendit të Arbënit, autori parashtrohet idetë e tij rreth shkrimit të shqipes mesjetare, në një mënyrë origjinale e jo sipas skemave të njohura përgjithësisht, edhe pse brenda fakteve të ditura historike. Ai shtron disa çështje të rëndësishme të historisë së shkrimit të shqipes në formë pyetjesh, të cilat meritojnë studime të thelluara monografike historike e kulturore, të cilat në atë kohë ende mungonin. Këto pyetje lidhen me arsyet e mbizotërimit të alfabetit latin në fillimet e shkrimit të shqipes dhe të triumfit të tij përfundimtar në shqipe, me arsyet e fillimit të traditës shkrimore në veri të vendit dhe qëndresën e rëndësinë e saj në historinë e kulturës shqiptare, më tej me arsyet përse shqipja e teksteve të vjetra të veriut nuk arriti të përgjithësohet asnjëherë si gjuhë letrare për mbarë popullin etj. Këto pyetje gjithsesi e marrin nga një përgjigje, qoftë edhe jo të thelluar në bazë studimesh të posaçme, por mjaft të saktë e realiste, që merr për bazë rrethanat historike, kulturore e fetare të zhvillimit të kombit shqiptar, pushtimet shumëshekullore të perandorive të mëdha dhe ndikimet e tyre kulturore, ideologjike e fetare, me ndasitë e rivalitetet përkatëse, dallimet e mëdha sociale qytet/fshat, dallimet krahinore Veri/Jug, proceset konvertuese të kaheve të ndryshme (islamizim më së shumti, por edhe katolicizim në zonat verilindore ortodokse). Me një përshkrim historik të ngjeshur jepet një tablo përgjithësuese e rrethanave të ndërlikuara etnike, konfesionale, kulturore e krahinore që bënë të mundur ruajtjen e katolicizmit në Verilindje e Veriperëndim, kushtëzuar kjo edhe nga specifika e fesë katolike për ta pasur qendrën shpirtërore dhe organizative-kishtare në Evropën e përparuar, me interesat e veta për

ruajtjen e ndikimit të saj fetar e kulturor në Ballkanin perëndimor. Që këtej rrjedhin dhe arsyet e përdorimit të shqipes në shërbimet fetare, kryesisht në variantin verior e, lidhur me të, të alfabetit latin në fillimet e shkrimit të saj, por që u rimor më pas mbi baza unike kombëtare nga Rilindja me programin e saj progresist të orientuar nga Perëndimi.

Alfabeti latin që huazuan autorët e vjetër për shkrimin e shqipes sigurisht që nuk ishte i mjaftueshëm për sistemin tingullor të shqipes, duke qenë i përshtatur për një strukturë tjetër tingullore e morfologjike. Prandaj autori e ka parë të nevojshme të ndalet në përshkrimin e sistemit fonetik të latinishtes dhe në alfabetin me të cilin është pasqyruar ky sistem, për të kuptuar edhe analizat gjuhësore dhe punën krijuese që kanë bërë autorët e vjetër për përshtatjen e alfabetit latin për shqipen dhe plotësimin e mungesave të këtij alfabeti me grafi të alfabeteve të tjera. Më shumë vështirësi paraqet kombinimi i dy traditave shkrimore, latine dhe italiane, prandaj kërkohet një interpretim i shumanshëm, duke u nisur edhe nga perspektiva e shqipes së sotme, për aq sa është e nevojshme për të parë zhvillimet e sistemit, por duke bërë edhe analiza gjuhësore kombinuar me analiza filologjike, krahasime me sistemin e italishtes e të latinishtes, e sidomos duke u mbështetur edhe në analiza statistikore të të dhënave që japin tekstet. Të gjitha këto premisa autori i shtron si të nevojshme e megjithatë jo gjithmonë rezultative, prandaj metoda më efikase e mundshme do të jetë vështrimi i gjendjes së opozicioneve (korelacioneve ose ndërlidhnive) dhe prej këtej evidentimi i tipareve dalluese, për të nxjerrë në pah rezultate më të qëndrueshme.

Autori e vlerëson punën e bërë nga studiuesi paraardhës i Kuvendit të Arbënit V. Malaj⁸ për paraqitjen tabelare të alfabetit të autorëve të vjetër si një pasqyrë historike që jep dorë për të vështruar zgjidhjet grafike të autorëve të ndryshëm, por që mbështetet në shkrim dhe nuk përfshin realitetin tingullor që qëndron pas grafemave të veçanta. Ai ndjek një rrugë tjetër në mënyrën e procedimit, duke u nisur nga vjelja e tekstit në tërësi, gjithsesi, për metodat manuale të kohës, e kufizuar në një numër faqesh të caktuar, të zgjedhur në çdo 10 faqe të tekstit, për rastet joproblematike të interpretimit dhe në vjelje të plota për rastet e dyshimta.

Në vijim, punimi përqendrohet në dy drejtime kryesore, që përbëjnë thelbin e tij. Së pari në sistemin grafik të tekstit të Kuvendit të Arbënit dhe interpretimin e tij, dhe së dyti, në analizën fonologjike të idiomës që qëndron prapa sistemit grafik të tekstit, si përshkrim sinkronik i fazës gjuhësore të shekullit XVIII të arealit verior të shqipes.

8 Vincenz Malaj, *Kuvendi i Arbënit. Concilio Nazionale Albanese del 1703. Inquadramento storico, testo albanese e glossario*, Università di Roma, Facoltà di lettere e filosofia, Corso di laurea in Lettere, tesi di Laurea, anno acc. 1971-1972 (dorëshkrim i doktoratës). Tashmë botuar tri herë në shqip, bot. i fundit Misioni françeskan, Tuz, 2017.

Në pjesën e parë vështrimi analitik thellohet në grafisë e tekstit të Kuvendit për të hetuar vlerat tingullore që qëndrojnë prapa grafive të veçanta dhe kombinimeve të tyre. Në një kapitull të gjerë merren në shqyrtim të gjitha shenjat grafike të tekstit dhe kombinimet e tyre, duke filluar nga përshkrimi formal i përdorimit të tyre (në variant majuskul apo minuskul, me theks ose jo, të thjeshta ose të dyfishuara etj.), pozicionet e tyre brenda fjalës së shkruar me shembujt përkatës dhe me të dhënat statistikore sa herë del në tekst në secilin rast, në korpusin e vjelë nga teksti. Interpretimi fonetik i grafive të veçanta bëhet në bazë të alfabetit latin të tekstit e në kuadër të përdorimit të këtij alfabeti në gjuhë të tjera, në bazë të elementeve të tjera grafike që jep vetë teksti dhe në analogji me përdorimin e tyre në traditën italiane, siç janë shenjat e theksit për të shënuar hapjen apo shkurtësinë e zanores, dyfishimi i grafemave zanore për të shënuar gjatësinë e tyre etj. Në qoftë se teksti i Kuvendit nuk jep çelës leximi për grafi të caktuara, merren në vështrim autorët e tjerë të shqipes së vjetër si Bogdani, Bardhi etj. që mund t'i ofrojnë këto mundësi leximi⁹. Duke marrë parasysh këtë kompleksitet të dhënash, si edhe pozicionin e grafemës brenda fjalës së shkruar dhe theksimin përkatës të tingullit të saj, jepet interpretimi i grafemës, si dhe të kombinimeve të saj grafike, me përshkrimin e përbërësve fonetikë, disa prej të cilëve lihen të hapur për mundësi variacioni, për sa kohë kemi të bëjmë me një fazë gjuhësore e dialektore të paregjistruar fonetikiht e të largët nga gjendja e sotme. Secila nga grafemat, përkatësisht kombinimet e saj, shoqërohen me shembujt ilustrues nga korpusi i vjelë në tekst. Në rastet e interpretimit të hamendësuar të vlerave fonematike që shprehin grafemat, shembujt grupohen nën vlerën përkatëse, por duke e shënuar supozimin shprehimisht. Kështu ndodh, për shembull, në rastin e fjalëve që supozohet se përmbajnë zanore hundore, edhe pse teksti nuk i shënon me ndonjë mënyrë të veçantë.

Në rastin e grafive të dyshimta ose shumëvlerëshe punimi ndërmerr analiza historiko-gjuhësore dhe krahasime me tekstet paraardhëse të Kuvendit për të zbuluar realitetin tingullor që ato pasqyrojnë. Kështu veprohet me veçimin e tingull-fonemës *ë*, e cila në tekst nuk dallohet

9 Për shembull, në rastin e mungesës së shënimit eksplisit të hundorësisë në tekstin e Kuvendit, një hundorësi kjo e padyshimtë për realitetin fonetik të gegërishtes veriore të shek. XVIII, autori i referohet Bogdanit apo Dorëshkrimit të Grottaferratës ku shkronja *n* në raste të caktuara shërben si shenjë hundorësie (*ansctè* = [âshtë], *scanssè* = [shtësë], *brençi* = [brëzi] etj.). Bogdani e shpreh këtë parim drejtshkrimor edhe në udhëzimet e tij për leximin e tekstit (*Avvertimenti per leggere correttamente in lingua albanese*): A, con n, si pronuncia col naso passando n sotto l'eclisse, come *ansctè vertet* è vero. (A me *n*, shqiptohet me hundë, duke u eklipsuar *n*-ja, si *ansctè vertet* "è vero"). Gjithashtu, Bogdani jep elemente grafike edhe për dallimin e zanores së mesme /ə/ (= [ê]) përmes grafemës *è*, ndonëse me shumë luhatje në përdorim.

grafikisht nga *e*-ja. Në raste të tjera analiza historiko-gjuhësore kombinohet me analizën funksionale në rrethana kontekstuale e sintagmatike të tingujve të shprehur me grafemat apo kombinimet e tyre, si psh. në interpretimin dhe realizimin fonetik të grafive *i* dhe *j* dhe të kombinimeve të tyre, të dubleteve grafike *ue/uo*, apo në shpjegimin e mungesës së hundorësisë së zanores *o*¹⁰ etj. Për sa u përket grafemave bashkëtingëllore problemet më të mëdha interpretuese i paraqesin grafitë C dhe G me kombinimet e tyre të cilat shfaqen si polifunksionale në tekstin e shqyrtuar e në përgjithësi në tekstet e vjetra. Gjithsesi, edhe ky tekst na tregon qartë se shqipja veriore e shekujve XVII-XVIII i dallonte qiellëzoret nga afrikatet. Lidhur me luhatjet që paraqesin tekstet e vjetra në përdorimin e grafemave L dhe λ për shënimin e laterales palatale, përkatësisht velare, autori, edhe në bazë të të dhënave statistikore nga teksti, arrin në përfundimin e qartë që vlen edhe për tekstet e tjera, se të gjitha inkonsekuencat në këtë drejtim¹¹ duhen shpjeguar si lëshime.¹²

Si përfundime të analizës së grafisë së tekstit të Kuvendit të Arbënit autori thekson nga njëra prirjen për një stabilizim më të dukshëm në krahasim me tekstet paraardhëse, madje edhe me Bogdanin, ku dallohet prirja për specifikim në shënimin e tingujve *l, ll, r, rr, s, sh, k, q, ç, kj*, prirja për reduktimin e dyshkronjëshave, fillimin e dallimit *i / j*, dallimin e qartë *y / u* etj. Nga ana tjetër shënohet edhe ndonjë hap mbrapa në raport me Bogdanin, siç është mungesa e dallimit grafik të zanores *ë*, mungesa e shënimit të hundorësisë së zanoreve (te Bogdani shënohet me një *n* pas zanores hundore), etj. Teksti i Kuvendit shënon përparim edhe në drejtshkrimin e shqipes, sidomos në shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras dhe në përdorimin e shkronjave të mëdha e të vogla.

Drejtimi i dytë thelbësor i punimit është përshkrimi i sistemit fonetik të shqipes së kapërcyellit të shekujve XVII-XVIII i nxjerrë në mënyrë induktive në bazë të interpretimit të grafisë së tekstit. Autori shënon paraprakisht kufizimet e një studimi të tillë dhe nevojën për krahasime të mëtejshme me përfundimet e studimeve diakronike të sistemeve të shqipes në planin e përgjithshëm dhe në atë dialektor, për sa kohë që ky tekst nuk është i një shqipfolësi burimor, paraqet një shqipe letrare deri diku të normativizuar, përmban një korpus të kufizuar dhe një numër fjalësh të huaja më të madh se realiteti. Për sa i përket metodës së interpretimit fonetik të zbatuar në shqyrtimin e materialit, ai ka zgjedhur metodën e gjuhësisë funksionale evropiane, sipas parimeve teorike të André Martinet-së dhe Nikolay Trubetskoy-t, për të cilën realiteti fizik ka rëndësi për atë që reflektohet

10 Kjo dukuri vihet re edhe te Bogdani.

11 Inkonsekuenca që nënkuptohen në raport me shpërndarjen e këtyre dy fonemave në shqipen e sotme.

12 R. Ismajli, vep. cit., f. 132.

në komunikim¹³. Kjo do të thotë se nuk ndiqet metoda e organizimit të materialit fonetik sipas tipareve dalluese të fonemave në opozicione binare, por në qendër të vëmendjes është fonema në aspektin e saj funksional. Qasja e studimit është sinkronike në gjuhësinë diakronike, pra analizë gjuhësore e një faze të caktuar të shqipes në një hapësirë gjeografike të caktuar dhe sipas një teksti të shkruar. Të gjitha këto premisa kushtëzojnë në shumë raste edhe shpjegime rindërtuese me natyrë hipoteze.

Analiza e sistemit fonematik të gjuhës së tekstit të Kuvendit përfshin përshkrimin e tipareve të secilit tip fonemash bashkë me alofonet e tyre, duke përfunduar me paraqitjen e tyre si sistem zanoresh e bashkëtingëlloresh. Kjo analizë nxjerr në pah një sistem zanoresh mjaft kompleks dhe të pasur për gegërishten veriperëndimore të fillimshkullit XVIII, që karakterizohet nga tiparet korelative sipas shkallës së ngritjes, sipas radhës, hundorësisë, buzorësisë dhe gjatësisë. Tipari i hundorësisë, i cili nuk shënohet me ndonjë farë mënyre në tekst, vetëm deduktohet se duhet të ekzistojë, në bazë të krahasimit me tekstet e vjetra paraardhëse, sidomos me atë të Bogdanit (shih shënimin 7). Sistemi i zanoreve vështrohet edhe në dinamikën e tij, duke zbuluar vatrat e sistemit ku gjenden shtysat për lëvizje të mëtejshme të tij. Këto vatra janë zbrazëtitë në korelacione nga njëra anë, mbingarkesat nga ana tjetër si dhe procese të ndryshme fonetike që ushtrojnë presion mbi sistemin dhe e shpien drejt ndryshimit. Autori paraqet edhe skematikisht prirjet e zhvillimit të mëtejshëm në sistemin e zanoreve të shqipes veriore të shkullit XVIII. Gjithmonë në bazë të interpretimit të grafive të tekstit të Kuvendit të Arbënit por edhe me krahasime me tekstet e vjetra dhe me të folmet brendadialektore analizohen edhe fonemat bashkëtingëllore në pikëpamje fonologjike, sipas vendit ose mënyrës së nyjetimit në: mbylltore, fërkimore, hundore, dridhëse, anësore, fishkëlluese/shushuritëse dhe bashkëtingëlloret /h/, duke përshkruar tiparet e tyre fonologjike, distribucionin, komutacionin (zëvendësueshmërinë) me fonema të tjera, variacionet kontekstuale të tyre etj. Grupet e fonemave e sidomos grupet që përmbajnë çifte minimale përshkruhen edhe në dallimet artikulative mes tyre në këndvështrim funksional duke shpjeguar edhe shkaqet e ndryshimeve dialektore ose diakronike të tyre (psh. shkaqet e përzierjes të *ll* me *dh* në disa të folme të veriut, neutralizimi i fonemave hundore *n* dhe *m* në disa të folme të tjera -*mjegull*/*njegull*, shkaqet e rënies së shpeshtë të bashkëtingëllores *h* si e painkuadruar në sistem etj.)

Disa herë analiza sinkronike e çifteve të caktuara të fonemave me distribucionin dhe zëvendësueshmërinë e tyre shpie në rindërtime diakronike interesante për fonetikën historike të shqipes. Kështu është rasti i anësoreve /l/ e /ll/, në të cilat e dyta në tekstin e Kuvendit del shumë rrallë në fillim të fjalës dhe vetëm në huazime, gjë që tregon, sipas

13 R. Ismajli, vep. cit., f. 155.

autorit, se “në një fazë shumë të hershme shqipja kishte vetëm një /l/ me fushë shumë të gjerë dispersioni, e cila realizohej ndryshe në kontekste të ndryshme sintagmatike, sidomos midis zanoreve, kështu që më vonë këto variante u fonologjizuan”¹⁴. Distribucioni shumë i kufizuar i afrikates fishkëlluese *c* dhe alternimi i tij i dendur me fërkimoren fishkëlluese *s* lë të supozohet se në kohë më të hershme ai do të ketë qenë variant i lirë i *s*-së.¹⁵ Fonema *xh* (= /dʒ/) nga gjithë analiza e sistemit fonetik dhe e leksikut të shqipes me praninë e saj kryesisht në fjalët e huazuara rezulton mjaft e re në shqipen.

Studimi sjell edhe kontribute teorike për fonologjinë e shqipes, siç është teoria e rrokjes dhe e ndarjes në rrokje mbi bazën e bërthamës rrokjeformuese, që jep rezultate më të mira për analizën e shqipes, qoftë të sotme qoftë të shekullit XVII. Në këtë kontekst teorik shtrohet problemi nëse shqipja e vjetër ka pasur bashkëtingëllore rrokjeformuese në raste si *rrgjand* te Kuvendi dhe te autorët e vjetër apo *en, enbetune* etj. te Buzuku.

Lidhur me gjatësinë në rrokje të patheksuar, që del në tekstin e Kuvendit por edhe në tekstet e tjera të vjetra dhe në gegërishten veriperëndimore, autori jep shpjegimin e tij se kjo është një gjatësi që del jashtë sistemit, ndryshe nga gjatësia në rrokje të theksuar brenda sistemit.

Për arsyetimin e ndryshimeve kualitative të fonemave bëhet analiza funksionale e tyre (psh. bashkëtingëllorja *r* është bërë pak më e prapme (retroflekse), në disa të folme u bë rrafshimi i dallimit *r/R* etj.) Autori jep kontribute edhe për fonetikën e shqipes së sotme, duke qenë, besoj, i pari që ka përshkruar një dukuri fonetike që ka filluar më herët dhe që sot është përgjithësuar sidomos në qytete, siç është /*r*/-ja retroflekse e ngjashme me /*r*/-në e anglishtes.

Sistemi fonematik i shqipes së Kuvendit të Arbënit, sipas autorit, mbështetur edhe në periodizimin e Selman Rizës, rezulton se është në vija të përgjithshme ai i shqipes së re, varianti i gegërishtes veriperëndimore, në të cilin një sërë procesesh që më vonë do të stabilizohen, tashmë kanë filluar.

Punimi i kushton vëmendje, në një kapitull të veçantë, edhe analizës së tekstit në pikëpamje të strukturimit e të organizimit të tij, të llojeve të tekstit dhe destinacioneve të tyre, të funksioneve të shqipes në institucionet kulturore e zyrtare të kohës, në këndvështrimin e gjuhësisë së tekstit. Vështrimi është përqendruar sidomos në funksionet e foljeve, si bartëse të bërthamës së veprimit në fjali, duke analizuar përdorimin e kohëve të foljeve sipas tre boshteve të informacionit: qëndrimi i folësit (H. Weinreich), perspektiva e të folurit, relievizimi i tekstit, kombinimi i të cilave paraqet një pamje më të plotë të kohëve të foljeve të shqipes, mënyrave

14 Po ai, po aty, f. 192.

15 Po aty, f. 196.

e aspekteve të përdorura në tekstin e Kuvendit, si një tekst rrëfimor por edhe koment. Rexhep Ismajli ka qenë ndër të parët në gjuhësinë shqiptare që ka ndërmarrë studime mbi bazën e gjuhësisë së tekstit, ndër të tjera për çështje të perspektivës së të folurit dhe qëndrimit të folësit mbi kohët e foljeve,¹⁶ dhe këtë metodë e ka zbatuar edhe në një tekst të vjetër shqip siç është Kuvendi i Arbënit.

Punimi merret edhe me çështje të stilit të tekstit të Kuvendit, me ndërtimin e tij në mënyrë që të jetë sa më ndikues te lexuesi në përputhje me qëllimet e hartimit të tij. Disa elemente të tilla janë fraza e gjatë, e ftohtë, rationale e urdhëruese, por edhe shprehje emocionale, citate të etërve të kishës, zgjedhja e leksikut karakterizues të të mirëve e të këqinjve, përdorimi i një stili solemn dhe imponues midis nxitjes dhe kërcënimit etj.

Disa konsiderata i kushtohen edhe përkthimit shqip të tekstit burimor latinisht të Kuvendit, përkthim që vlerësohet si me të meta dhe i fjalëpërfjalshëm, deri dhe morfemë për morfemë, dhe me rendin e fjalëve të ruajtur sipas gjuhës origjinale. Ky lloj përkthimi rob i origjinalit nuk lejon, spas autorit, të dalin qartë strukturat e mnirëfillta të shqipes, prandaj duhet marrë me rezervë kur studiohet në këtë vështrim. Nga një analizë e pak shembujve nga teksti, del se përkthyesi nuk e ka njohur mirë latinishtes dhe njëkohësisht nuk ka qenë folës burimor i shqipes. Për këtë arsye doli edhe nevoja e ripërkthimit të tij nga Engjëll Radoja në vitin 1872.

Meqenëse në Kuvendin e Arbënit del për herë të parë emri kombëtar i shqiptarëve, të paktën për sa njihej deri vonë¹⁷, autori e ka gjykuar të nevojshme të hedhë një vështrim mbi problematikën ende të pasqaruar deri në fund të këtij emërtimi karakteristik me të cilin shqiptarët quajnë veten. Para se të kalojë në këtë vështrim, autori ndalet në emrin më të hershëm të shqiptarëve, *arbën/arbër*, historinë dhe përhapjen e tij në lashtësi e në mesjetë, variantet e ndryshme me të cilat del ky emër te fqinjët e shqiptarëve, duke vendosur edhe disa kronologji relative të këtyre varianteve. Lidhur me emrin *shqiptar*, për rrugën e formimit të tij autori niset nga ndajfolja *shqip* “qartë, kuptueshëm”, duke pranuar tezën e Meyerit për prejardhjen latine të kësaj fjale nga *excipiō* “marr, kap, kuptoj” (që nënkupton së pari një huazim foljor *shqipoj*), ku rrënjës *shqip-* i është shtuar prapashtesa *-tar*, ndërsa kalimin e pazakonshëm nga ndajfolja në

16 Në veprat *Shenjë dhe ide*, Prishtinë, 1974, *Shumësia e tekstit*, Prishtinë, 1980, khs. B. Rugova, “Past Tenses of Indicative in Albanian in Different Text Categories”, në: *Poznać Bałkany: historia – polityka – kultura – języki*, III, Zakład Języków Słowiańskich i Bałkanistyki UMK, Toruń 2012, f. 123.

17 Me botimin e fjalorit dorëshkrim të Francesco Maria da Lecces, *Dittionario italiano-albanese* (1702), botim kritik, me hyrje dhe fjalësin shqip nga Gëzim Gurga, *Botime françeskanë*, 2009, në të cilin dëshmohet emri *shqiptar*, u avancua me një vit dalja e emrit kombëtar të shqiptarëve.

emër e shpjegon me ndërmjetësimin e formës emërore hipotetike **shqipë*¹⁸.

Formimi i emrave etnikë nga ndajfolje që shënon gjuhën + prapashtesën *-(t)ar* në gjuhën shqipe na del tani i mbështetur edhe nga dëshmia e emërtimit *gërqishtar* “grek minoritar” që përdorin banorët e vjetër të Gjirokastrës për fqinjët e ardhur nga Dropulli në qytet¹⁹, po edhe *gërqishtjar* në këngë popullore të Himarës.²⁰

Arsyet e përhapjes e të përgjithësimit të këtij emri ndër banorët e hapësirës shqipfolëse ballkanike autori i sheh në kushtet e krijimit të vetëdijes së kombit në rrethanat politike të lëvizjes së Rilindjes. Si rrethana historike e fetare shihen ndryshimet social-politike në shekullin XVIII me zhvillimin e tregtisë dhe të kontakteve mes qyteteve shqiptare dhe me qendrat e mëdha tregtare e administrative jashtë hapësirës shqipfolëse nën Perandorinë Osmane si dhe ndikimet nga Perëndimi që vinin nga drejtime të ndryshme, ndërkohë që popullsia shqipfolëse ishte trikonfesionale. Në këtë kontekst ballkanik multietnik e plurifetar brenda të njëjtit formacion shtetëror lindi nevoja për popullsinë arbëre, të islamizuar masivisht në shekullin XVIII, të identifikohesh tashmë vetëm nga gjuha si mjeti kryesor i identitetit kombëtar, ndërsa etnonimi *arbër* ruante ngjyrimin semantik të shqipfolësit të krishterë që lidhej disi me të kaluarën.

Studimi i tekstit të Kuvendit të Arbënit nuk lë jashtë vëmendjes edhe çështjet e leksikut të veprës me shtresëzimet e tij. Megjithëse në pak faqe, në këtë paragraf jepen në mënyrë koncize e të përgjithësuar aspektet kryesore leksikore të këtij teksti, si fushat semantike ku mbizotëron leksiku abstrakt, me termat fetare dhe të administratës kishtare, raporti fjalë vendi - huazim, ku autori i përktimit shqip të Kuvendit si folës joburimor i shqipes nuk është në gjendje të bëjë dallime dhe nuk ka synimet puriste të autorëve të vjetër për të përdorur fjalë të vjetra shqipe, kështu që si kriter të zgjedhjes së fjalëve merr shkallën e përhapjes së tyre në përdorimin e folur. Kështu përmes këtij teksti marrim të dhëna relativisht objektive për përhapjen e huazimeve të ndryshme në këtë fazë gjuhësore të shqipes, veçanërisht për huazimet turke. Këto kanë hyrë tashmë deri në terminologjinë fetare katolike të shqipes, siç duket nga titujt e kapitujve të pasqyrës së lëndës së tekstit, ku gjenden orientalizmat *tefteri*, *esapi*, *hatri*²¹. Sidoqoftë huazimet turke të Kuvendit janë ende shumë të pakëta në krahasim me vërshimin e

18 R. Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit*, vep. cit., f. 227 v. Për emrin *shqiptar* shih tani së fundi edhe Bardhyl Demiraj, “Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë”, Naimi, Tiranë, 2014.

19 Mimoza Karagozi-Kore, *Gjirokastra. Vështrim historik, gjuhësor, etnologjik*, Dudaj, Tiranë, 2014, f. 188.

20 /si tha gërqishtjari Pano/: khs. Kozma Nushi, *Këngë popullore dhe vjersha patriotike të Himarës dhe të Labërisë*, transkriptuar dhe përgatitur nga Anastas Kondo, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 95.

21 R. Ismajli, vep. cit., f. 235.

tyre në ripërkthimin e Radojës të vitit 1872.

Më në fund, një studim për gjuhën e një teksti të shekullit XVIII nuk mund të linte mënjanë çështjen e përkatësisë dialektore të tij, gjë që trajtohet në një paragraf të veçantë. Kësaj pyetjeje nuk mund t'i jepet një përgjigje e prerë, për sa kohë teksti shfaq prirje normativizuese dhe autori i përkthimit nuk është folës burimor i shqipes. Nga përfundimet që ka nxjerrë Vinçenc Malaj në studimin e tij duke u nisur nga zonat ku kishte shërbyer përkthyesi i supozuar i tekstit të Kuvendit, Patër Egidio d'Armento, baza dialektore e tekstit ishte dialekti i Hotit e Grudës, por me ndikime të rëndësishme nga tekstet e vjetra paraardhëse të Bardhit, Budit e Bogdanit që i kishin në duar të gjithë misionarët. Për disa elemente të tjera gjuhësore vjen në vështrim edhe e folmja e Krajës. Rexhep Ismajli arrin në një përfundim të ngjashëm duke analizuar tiparet dalluese dialektore të tekstit, si refleksët *kj, gj* të grupeve të vjetra *kl, gl*, grupi zanor *uo* krahas *ue*, nyja shquese *u* pas velareve, prirja për zhdukjen e kundërvënies /ll/:/dh/, përemri pronor shumë *taj*, ndërtimi i rrjedhore shumë me mbaresën *-et* (*lopet*) etj. të cilat shpjen në gegërishten veriperëndimore me mbështetje më të madhe në të folmet e Malësisë së Madhe e të Krajës²².

Këto ishin punimet e fazës së parë të pjekurisë shkencore të Rexhep Ismajlit. Në këto punime ai shënon arritje gjurmëlënëse në fushë të gjuhësisë historike, të fonetikës e të fonologjisë, të filologjisë tekstuale, të historisë së kulturës shkrimore dhe të gjuhësisë së tekstit shqip. Në disa nga këto fusha ai ka bërë edhe punë prej pionieri në studimet shqiptare. Në jetën e tij të ngjeshur shkencore studimi i teksteve të vjetra shqipe ka qenë një nga fushat e tij të preferuara. I urojmë edhe shumë vite të tjera veprimtarie shkencore në të mirë të gjuhësisë shqiptare.

22 R. Ismajli, vep. cit., f. 244-250.